

INTEGRIMI NË BE

MINISTRI HASANI: JO MËVONESA E PENGESA PËR BALLKANIN PERËNDIMOR

LUKSEMBURG

Me ftesë të Përfaqësuesit të Lartë/Zv. Presidentit të Komisionit Evropian, Josep Borrell, MEPJ Iglj Hasani mori pjesë në takim informel mes Ministrave të Jashtëm të BE dhe Ministrave të Jashtëm të Ballkanit perëndimor, ku rikonfirmoi përafrimin e plotë të Shqipërisë me politikën e jashtme dhe ato të sigurisë të BE si dhe nënvizoi integrimin gradual si një prej mekanizmave të duhur për zgjerimin e BE.

GREQI

MEPJ Iglj Hasanimori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare për Paqen dhe Rritjen e Qëndrueshme, që u mbajt në Athinë. Ministri Hasani theksoi se integrimi i Shqipërisë dhe rajonit ka mbetur në stacion prej vitesh, teksa nënvizoi se qasja, ritmi dhe angazhimi i BE-së për këtë proces duhet të ndryshojë.

AUSTRI

MEPJ Iglj Hasani, mori pjesë në konferencën e Grupit të Miqve të Ballkanit Perëndimor me MPJ-të e vendeve të BP-së, kutheksoi se Bashkimi Evropian duhet të mbajë një afat kohor realist dhe të përkushtuar për procesin e anëtarësimit, teksa nënvizoi se Shqipëria e ka treguar vendosmërinë e saj për përsheptimin e procesit të integritimit.

KROACI

MEPJ Iglj Hasani mori pjesë në Forumin 2024 të Dubrovnikut, ku theksoi faktin senjë qasje e koordinuar ndërmjet BE-së dhe SHBA-së për politikën e Ballkanit Perëndimor mund të ofrojë një kornizë të qëndrueshme dhe mbështetëse për reformat në procesin negociues, duke zbutur ndikimin e aktorëve të jashtëm si Rusia dhe Kina.

MINISTRI HASANI TUR VIZITASH NË VENDET ANËTARE TË BE

SUEDI

Në vizitën zyrtare në Suedi, MEPJ Iglj Hasani u prit në takim nga homologu i tij, Tobias Billström, ku ata vlerësuan se të dyja vendet ndajnë të njëjtat vlera dhe qëndrime sa i përket zgjerimit të BE, integritit të Ballkanit Perëndimor etj. Gjatë qëndrimit në Stokholm, Ministri Hasani u takua me deputetët e parlamentit suedez me origjinë shqiptare; me Kryetarin e Parlamentit, Andreas Norlen; me Ministrin për Çështje të Bashkimit Evropian, Jessika Rosell, grupin parlamentar të miqësisë për Ballkanin Perëndimor, me përfaqësues të komunitetit të biznesit vendas etj.

FINLANDË

MEPJ Iglj Hasani u prit në një takim nga MPJ e Finlandës, Elina Valtonen. Ministri Hasani vlerësoi mbështetjen e Finlandës në rrugëtimin e Shqipërisë drejt anëtarësimit në BE, teksa ritheksoi se Shqipëria i ka plotësuar të gjitha kushtet për mbajtjen e Konferencës së dytë Ndërqeveritare. Ministri Hasani zhvilloi gjithashtu takime me Presidentin e Finlandës, Alexander Stubb, me Ministrin për Çështjet Evropiane dhe Drejtimin e Pronësisë, Anders Adlercreutz, etj. Ministri Hasani firmosi memorandumimin e mirëkuptimit, për anëtarësimin e Shqipërisë në Qendrën Evropiane të Ekselencës së Helsinkit Kundër Kërcënimeve Hibride (Hybrid CoE).

RUMANI

MEPJ Iglj Hasani u prit në takim nga Presidenti Klaus Iohannis, takim gjatë të cilit vlerësoi mbështetjen e Rumanisë në rrugëtimin e Shqipërisë drejt BE. Ministri Hasani zhvilloi takime dypalëshe edhe me zv. Kryeministrin dhe Ministrin e Brendshëm, Catalin Predoin, dhe Ministrin e Punës dhe Mbrojtjes Sociale, Simona Brucura Oprescu, me të cilën nënshkroi "Marrëveshjen administrative për zbatimin e marrëveshjes së sigurimeve shoqërore". Në ditën e dytë, MEPJ Iglj Hasani, u prit në takim nga homologia, Luminita Odobescu, ku së bashku nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit në fushën e trajnimeve diplomatike.

KOLEGJI I EVROPËS

MINISTRI HASANI: RAJONI NË HARTËN E PROFESIONISTËVE TË BE

HAPJA E KOLEGJIT TË EVROPËS NË TIRANË

MEPJ Iglj Hasani dhe Drejtorja e Programit pilot të Akademisë Diplomatike Evropiane, Federica Mogherini, i uruan mirëseardhjen studentëve, në trajnimin e zhvilluar nga Kolegji i Evropës me mbështetjen e Mbretërisë së Holandës. Ministri Hasani shprehu mirënjohje ndaj qeverisë shqiptare për hapjen në kohë rekord të Kolegjit të Evropës në Tiranë, teksa theksoi se Kampusi i Tiranës do ta vendosë rajonin tonë në hartën e profesionistëve të BE-së.

NISMAT RAJONALE

SHQIPËRIA MBYLLI ME SUKSES KRYESIMIN E BSEC

BSEC - Shqipëria mbylli me sukses kryesimin e Organizatës për Bashkëpunimin Ekonomik të vendeve të Detit të Zi. Ministri Hasani theksoi se Shqipëria ka bërë përpjekjet më të mira për të promovuar bashkëpunimin gjithëpërfshirës midis vendeve anëtare për gjetjen e zgjidhjeve të përbashkëta dhe adresimin unanimisht të gamës së gjerë të çështjeve ekonomike dhe politike.

GRATË NË DIPLOMACI

SHQIPËRIA PROGRES DHE MBËSHTETËSE E FUQIZIMIT TË GRUAS

"Gratë në diplomaci: Pse ka rëndësi?" – aktiviteti MEPJ në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Grave në Diplomaci. Në fjalën e tij përshëndetëse, MEPJ Iglj Hasani theksoi se për Shqipërinë, fuqizimi i grave dhe progresi i arritur në kuadër të barazisë gjinore mbeten disa prej përparësive kryesore.

PROJEKTI "ISHUJT"

MBI 2 MIJË SHËRBIME KONSULLORE NË GREQI E IRLANDË

U përmbyll me sukses nisma e MEPJ për ditët konsullore në Dublin, për t'i ardhur në ndihmë shtetasve shqiptarë që jetojnë e punojnë në Irlandë. Ditët konsullore janë pjesë e projektit "Ishujt", të zbatuar në Greqi e Irlandë në periudhën prill – qershor 2024, gjatë të cilit u ofruan rreth 2 mijë shërbime konsullore për shtetasit shqiptarë që banojnë në këto dy shtete.

EURO 2024

SHËRBIM KONSULLORE PËR TIFOZËT SHQIPTARË NË GJERMANI

Gjatë mbajtjes së Kampionatit Evropian EURO 2024, për muajin qershor, Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Republikën Federale të Gjermanisë ofroi shërbime konsullore në qytetet ku u zhvilluan ndeshjet, Dortmund, Hamburg dhe Dyseldorf. Ky projekt kishte si qëllim mbështetjen e shtetasve shqiptarë, të cilët u përballën me mungesën e dokumenteve të udhëtimit.

JAM SHQIPTAR

SHKOLLA VERORE PËR NXËNËS TË SHKOLLAVE TË GJUHËS SHQIPE NË DIASPORË

Shkolla verore "Jam Shqiptar" - Me pjesëmarrjen e 20 nxënësve nga diaspora shqiptare në Itali, MEPJ në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencinë Kombëtare të Diasporës dhe Qendrën e Botimeve për Diasporën, bënë të mundur organizimin e shkollës verore "Jam Shqiptar". Kjo nismë ishte një mundësi e veçantë për fëmijët shqiptarë të rritur jashtë atdheut, për t'u afruar me vendin e origjinës dhe për të mësuar edhe më tepër rreth vendit amë.

